



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.691/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Gëzim Llulluni dhe Nora Bllaca Dula, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ramadan Bunjaku, jurist, kundër të paditurit Q.J. nga Gjilani, rruga ..., për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.648/15, i datës 14.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 26.04.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit Q.J. nga Gjilani, rruga ..., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.648/15, i datës 14.12.2017, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.648/15, i datës 14.12.2017, në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër të paditurit Q.J. nga Gjilani dhe e ka detyruar të paditurin që paditëses në emër të borxhit t'ia paguajë shumën në lartësi prej 133.71 Euro, me kamatë ligjore siç paguajnë bankat për mjetet e deponuara pa destinim të veçantë duke filluar nga ngritja e padisë – propozimit e deri në pagesën definitive. Në pikën II (dy) të dispozitivit e ka obliguar të paditurin Q.J., që paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a me seli në Prishtinë t'ia kompensoj shpenzimet gjyqësore në lartësi prej 15 Euro, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i padituri, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim bërë Gjykatës së Apelit që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurit ndërsa aktgjykimi i goditur të ndryshohet me refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses si të pabazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja në cilësinë e kreditorit me datën 18.06.2012, në gjykatën e shkallës së parë, kundër të paditurit në cilësinë e debitorit, ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm, faturave VII-XII/11 – I/12, me propozim që të detyrohet i padituri, që paditëses në emër të shfrytëzimit të telefonit fiks për periudhën prej muajit korrik 2011 deri në muajin janar 2012, t'ia paguajë shumën prej 133.71 € euro, me kamatë ligjore, duke filluar nga dita e dorëzimit të propozimit në gjykatë e deri në pagesën definitive, në të kundërtën gjykata të bëjë përmbushjen e detyrimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit të paditëses, me aktvendimin Ekz.nr.316/2012, i datës 18.10.2013, e ka lejuar ekzekutimin e propozuar. I padituri brenda afatit ligjor kundër aktvendimit për lejimin e ekzekutimit ka paraqitur kundërshtim, duke i kontestuar shkaqet për të cilat është lejuar përmbarimi me arsyetimin se debitori duhet të lirohet nga pagesa e borxhit për shkak të vjetërsimit të tij, ku pas kësaj gjykata e shkallës së parë me aktvendimin E-1 316/12, të datës 16.01.2014, e len jashtë fuqie aktvendimin për lejimin e ekzekutimit, ndërsa propozimin për përmbarim e trajton si padi të rregullt civile.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë dhe rregullave të procedurës kontestimore, me datë 14.12.2017, ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën ka prezantuar i autorizuari i paditëses, ndërsa nuk ka prezantuar i padituri për të cilin kishte konstatuar se ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, gjersa mungesën nuk e kishte arsyetuar, me çka seancën e kishte mbajtur në mungesë të të paditurit, ku sipas propozimit të autorizuarit të paditëses ka administruar provat shkresore, me analizimin dhe vlerësimin e të cilave ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar në ligj, me çka edhe ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.648/15, i datës 14.12.2017, duke vendosur si në dispozitivin e të njëjtit.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të t 'paditurit se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të LPK-së (pretendim i cili është paraqitur në mënyrë të gjeneralizuar duke mos i specifikuar dispozitat dhe duke mos e specifikuar ndonjë rrethanë e cila do e arsyetonte pretendimin e tillë ankimor, (madje pala ankuese në ankesën e ushtruar i është referuar si dispozita të procedurës penale) ngase aktgjykimi i atakuar është mjaft i qartë si në pjesën e dispozitivit ashtu edhe të arsyetimit, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat duke i kualifikuar në pajtim me normat materialo juridike edhe ka nxjerrë përfundimin e drejtë lidhur me vendosjen meritore.

Të pabazuara qëndrojnë edhe pretendimet e të paditurit për gjendjen faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes lidhur me çështjen kontestuese në fjalë, qoftë sa i përket të provuarit të themelësisë së kërkesëpadisë por edhe lartësisë së saj, nga gjykata e shkallës së parë janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në procedurën kontestimore të udhëhequr tek ajo gjykatë, e cila gjendje faktike e vërtetuar dhe konstatuar nga gjykata e shkallës së parë është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit, pasi që kjo gjykatë vlerëson se ka mbështetje të plotë në provat shkresore.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, qartë konstatohet se i padituri gjatë periudhës kohore prej muajit korrik të vitit 2011 deri në muajin janar të vitit 2012, ka shfrytëzuar shërbimet e paditëses dhe i njëjti nuk e ka bërë pagesën për ato shërbime, andaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se i padituri ka për detyrim ta paguaj borxhin ndaj paditëses dhe atë duke u bazuar në dispozitën e nenit 154 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së e vitit 1978 (i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko civil) e cila parasheh *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon dëmi ka lindur pa fajin e tij”*.

Të pabazuar Gjykata e Apelit e vlerëson edhe pretendimin ankimor të palës ankuese për parashkrim të borxhit të kërkuar nga paditësja sipas padisë së ushtruar, ngase me shikim në shkresa të lëndës qartë konstatohet se në rastin konkret çështja që është paraqitur para kësaj gjykate ka të bëjë me kërkesa të cilat parashkruhen brenda afatit 1 vjeçar, ashtu siç parashihet me dispozitën e nenit 378 të LMD-së, andaj bazuar në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se borxhi i kërkuar i referohet periudhës kohore nga muaji korrik i vitit 2011 deri në muajin janar të vitit 2012, ndërsa propozimi për përmbarim në gjykatë është ushtuar me datën 18.06.2012, e nga një gjendje e tillë faktike rezulton se paditësja nuk e ka lëshuar afatin 1 vjeçar për të kërkuar borxhin e krijuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave i është referuar gjykata e shkallës së parë, e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë rrethanat e këtij rasti, rezulton se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditëses.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.691/18, me datë 26.04.2021

**Kryetarja e kolegjit,
Halide Reka, d.v**